



No. 68 prot  
Dt. 12/12/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 3 Datë 11.12.2018

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “EL-PROM” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 42, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, të Miratimit Paraprak për vazhdimin e procedurave nga MEI nr. 2373/4 Prot., datë 04.08.2017, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor, subjektit “EL-PROM” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujqor **Lumi i Veleshicës**, për prodhim energjie elektrike në fshatin Kalis, Njësia Administrative Kalis, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, subjektit “EL-PROM” sh.p.k. me administratore Znj. Zhaneta SHAHU.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, **HEC ZALL KALIS** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes :	X - 53 25 59.1; Y - 46 31 262.1; Z - + 450 m;
Koordinatat e godinës së centralit:	X - 53 10 01.4; Y - 46 31 421.6; Z - + 395 m;
Koordinatat e pikes së shkarkimit :	X - 53 10 01.4; Y - 46 31 421.6; Z - + 395 m;
Prurja mesatare:	Q mes = 2.57 m <sup>3</sup> /sek;
Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	Q llog = 5 m <sup>3</sup> /sek;
Prurja ekologjike:	Q ekol = 0.57 m <sup>3</sup> /sek;
Prurja që shkarkohet:	Q = 5 m <sup>3</sup> /sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak sipas akteve ligjore dhe nënligjore

